

KQZ  
U PROTOKOLLUA  
NR. 218 PROT  
DATE 13. 9. 18.

**“PARTIA KRISTIAN DEMOKRATE”  
TIRANE**

**AUDITIMI PASQYRAVE FINANCIARE**

**Per Periudhen 1 Janar- 31 Dhjetor 2017**

**Tirane 05 Korik 2017**

## RAPORTI I AUDITUESIT

### **Partia Kristian Demokrate**

*Adresa: Tirane, Bulevardi “Zogu I Pare”, Pallati 7 Katesh, Kati 5,*

Kemi audituar Pasqyrat financiare bashkelidhur te “Partise Kristian Demokrate” Tirane, te cilat perfshijne bilancin kontabel per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2017, pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve, per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime te tjera ne lidhje me to (anekse).

Pergatitja dhe paraqitja e sinqerte e ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit eshte pergjegjesi e Drejtimit te Partise. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit; per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel; si dhe per te bere çmuarjet kontabel qe jane te arsyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne kemi kryer auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin tone per te mare sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbeshtet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit. Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te shoqerise ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektiviten e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe te llogjikten e çmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.



Pasqyrat financiare jane pergatitur ne baze te parimit te arketim pagesave dhe jo ne baze te drejtave te konstatuara.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te pergatitura, me nje besueshmeri te arsyeshme japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per gjendjet financiare te "Partise Kristian Demokrate" me 31 Dhjetor 2017 , te rezultatit financiar dhe flukseve te parave per ushrimin e mbyllur, ne perputhje me Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

#### *Çeshtje te tjera*

Pasqyrat Financiare te Partise Kristian Demokrate per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 jane audituar dhe ka opinion te shprehur per ato.

Ne pasqyrat financiare jane paqyruar dhe arketim pagesat e periudhes 22.05.2017 deri 22.06.2017 te fushates zgjedhore per kuvendin e Shqiperise te vitit 2017 te audituar nga auditues ligjor te cilat nga ana e jone u muaren te mirqena.

*"LIRENG Auditing" sh p k*

Neshat MAZE(EKR)

Tirane , Korik 2018

SHENIME PLOTESUESE NE LIDHJE ME AUDITIMIN  
PARTIA KRISTIAN DEMOKRATE  
PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2017

**INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

Baza ligjore kryerjen e këtij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,
- Cdo dokument ligjor të marrë prane "Partise Kristian Demokrate" Tirane.
- Vendimi Nr 23 date 27.04.2018 i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

**TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PARTINE**

Subjekti zgjedhor "Partia Kristian Demokrate" e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, ne baze te Vendimit te Ministrise se Drejtesise Nr.9246 date 17.05.2012. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 "Per Partitë Politike", të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimpruese ", të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 "Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese", nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

*Subjekti zgjedhor "Partia Kristian Demokrate" është një organizatë shqiptare e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*Qellimi: Lufton per te krijuar kushtet e bashkimit shpirtëror dhe politik te popullit shqiperar, per lartësimin ekonomik dhe kulturor te tij dhe per barazine e te drejtave te njeriut...*

Qendra e partise është në *Andresa: Tirane, Bulevardi "Zogu I Pare", Pallati 7 Katesh, Kati 5,*

Organet drejtuese ne udheheqijen qendrore janë:

- Kongresi i Antaresis se Partise
- Komiteti Drejtues
- Kryesia e Partise
- Kryetari i Partise

Kryetar i partise është zgjedhur z.Dhimiter MUSIA i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të Partise Kristian Demokrate.

Te ardhurat Financiare te Partise perbehen nga :

- Kuotat e partise
- Buxheti i shtetit, sipas ligjit per financimin e partive politike.
- Te ardhurat nga shfrytezimi i pasurive te tundeshme dhe te pa tundeshme te partise
- Nga ndihmat e dhuratat nga anetaret dhe simpatizantet e partise

## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

### Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,, dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Leke.
- Rregullat për vlerësimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve.Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.
- Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve.Gjendjet e likujditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- Të Ardhurat Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.

### ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

#### 3. Aktivët Afatshkurter

Aktivët monetare te Partise perbehen nga mjetet ne banke e ne arke. Vlerat e mjeteve ne banke perputhen me gjendjen e bankes me 31.12.2013 dhe jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
<i>Totali Banke</i>	1,474,608	778,562
<i>Arka</i>	<u>0</u>	<u>0</u>
<b>Totali Banke+Arke</b>	<u><u>1,474,608</u></u>	<u><u>778,562</u></u>

Iventari perbehet nga vlera kancelari e te tjera ne magazine si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Artikuj inventari ne magazine	<u>0</u>	<u>0</u>
<b>Totali</b>	<u><u>0</u></u>	<u><u>0</u></u>

#### 4. Aktivët Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata ne vlere neto paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Ndertime e rikonstruksione	0	0
Mjete transp dhe inventar ekonomik	0	0
Te tjera	<u>576,778</u>	<u>761,240</u>
<b>Totali</b>	<b><u>576,778</u></b>	<b><u>761,240</u></b>

Partia ka kryer inventarin e AAM me 31.12.2012 me procedure inventarizimi.

## 5. Detyrime Afatshkurtra

Detyrime afatshkurtra detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Te pagueshme ndaj punonjesve	22,200	0
Sigurime shoqerore&Tap	0	0
Detyrime te tjera	<u>6,975</u>	<u>0</u>
<b>Totali</b>	<b><u>29,175</u></b>	<b><u>0</u></b>

### 5.1 Detyrime Afatgjata

Detyrime afatgjata detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Detyrime afatgjata	<u>2,022,211</u>	<u>1,539,802</u>
<b>Totali</b>	<b><u>2,022,211</u></b>	<b><u>1,539,802</u></b>

## 6. Fondet e veta

Fondet e veta detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Fondet Baze	0	0
Teprica e fondeve vitet e kaluara	0	778,562
Teprica(mungesa) e fondeve te vitit	<u>1,474,608</u>	<u>0</u>
<b>Totali</b>	<b><u>1,474,608</u></b>	<b><u>778,562</u></b>

## 7. Pasqyra e të ardhurave dhe Shpenzimeve

Partia Balli Kombetar ka realizuar te ardhura si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Gjendje fonde me 01.01.2013	778,562
Fonde KQZ ( Buxheti Shtetit)	6,304,503
Donacion	129,931
Te ardhura Kuota e anetareve	0
Te ardhura te tjera	<u>0</u>
<b>Totali</b>	<b><u>7,212,996</u></b>

Shpenzimet detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Shpenzime te ndryshme per postera, fletevolante, fletepalosje	<u>5,730,788</u>
<b>Totali</b>	<b><u>5,730,788</u></b>

#### 8. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Shpenzime për komisione& interesa bankare	<u>7,600</u>
Të ardhura nga interesat	<u>0</u>
<b>Totali</b>	<b><u>7,600</u></b>

#### 8. Pasqyra permbledhese e Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

**“Partia Kristian Demokrate” ka keto te Ardhura dhe shpenzime per vitin 2017.**

Nr	Burimet e Financimit	Sipas raportit financiar
<b>I</b>	<b>Te Ardhurat</b>	
1	Nga buxheti i shtetit	6,304,503
2	Nga fondet e vet Partia Balli Kombetar	0
3	Nga Donatoret(sponsorizime)	0
	-me banke(te mbartura nga viti 2016)	778,562
	-me banke(interesa bankare)	0
	-me arke	129,931
	-ne natyre	
	<b>Gjithsej te ardhura</b>	<b>7,212,996</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>0</b>
1	Shpenzime te ndryshme per postera, fletevolante, fletepalosje	5,730,788
2	Komisione bankare	7,600
	<b>Gjithsej shpenzime</b>	<b>5,738,388</b>
	<b>Gjendja me 31.12.2017</b>	<b>1,474,608</b>

Te ardhurat te perfituara dhe shpenzimet te kryera gjate fushtes elekorale te zgjedhjeve per kuvendin e Shqiperise te vitit 2017 jane te audituara dhe u moren te mirqena nga ana e jone .

Audituesi Ligjor(EKR)

Neshat MAZE